

TRAINKOS SH.A.  
TRAINKOS D.D.  
TRAINKOS J.S.C.  
Nr.No.Br. I-1164  
Dt. 13.08.2015  
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



## **R R E G U L L O R E**

**Për përgatitjen profesionale të punëtorëve të  
Hekurudhave të Kosovës-TRAINKOS Sh. A.**

**Fushë Kosovë  
2015**

Në bazë të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A në Mbledhjen nr. 56, të mbajtur më 07 dhe më 12.08.2015, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRGATITJEN PROFESIONALE TË PUNËTORËVE TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS-TRAINKOS SH. A.**

### **HYRJE**

Kjo rregullore është bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063, Ligjin për Arsimin para universitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Ligjin për Kualifikimet Kombëtare Nr. 03/L-060, direktivat e BE-së 2007/59 dhe 2010/36, në udhëzimet dhe rregulloret tjera të brendshme të kompanisë si dhe në rregulloren 646, e cila ka qenë e aplikuar deri më tani.

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore, është sigurimi i komunikacionit të rregullt dhe të sigurt hekurudhor, si dhe transport të sigurt dhe kualitativ të mallrave dhe udhëtarëve.

### **Neni 2**

#### **Fusha e zbatimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohet: Përgatitja e duhur profesionale e punëtorëve të hekurudhës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës të cilat janë drejtpërdrejtë të lidhura me komunikacionin hekurudhor, kushtet, kriteret dhe mënyrat e mundshme për të arritur deri te kualifikimi profesional për të gjithë punëtorët të cilët kryejnë punë dhe detyra të njëjta, të lidhura drejtpërdrejtë me komunikacionin hekurudhor.

1.2. Verifikimi i aftësive dhe njohurive profesionale do të bëhet përmes provimeve profesionale, shkollimit të detyruar periodik dhe mbajtja e provimeve periodike.

2. Përveç personelit i cili drejtpërdrejtë merr pjesë në komunikacionin hekurudhor, kjo rregullore aplikohet edhe te personeli i cili nxjerr dhe interpreton rregullore të ndryshme teknike të komunikacionit hekurudhor.

2.1. Personeli i cili merr pjesë në komisionet për aftësimin profesional të kuadrove të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në komunikacionin hekurudhor.

2.2. Personeli i cili organizon mbikëqyrjen mbi punën dhe kryerjen e punëve sipas rregullave në bazë të cilave organizohen dhe rregullohen veprimtaritë e komunikacionit hekurudhor dhe veprimtaritë e tërheqjes së trenave.

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **“Personeli”** - nënkupton të gjithë personat e angazhuar në marrëdhënie të rregullt pune në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh. A.

1.2. **“ARH”** - Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, organ ky i cili bënë mbikëqyrjen dhe rregullimin e regut hekurudhor në Republikën e Kosovës.

1.3. **“Provim Profesional”** - verifikimi i njohurive teorike dhe praktike për profesionin e caktuar.

1.4. **“Praktikant”** - personi i kualifikuar i cili themelon për herë të parë marrëdhënie pune, me qëllim që gjatë punës praktike të aftësohet për profesion të caktuar.

1.5. **“Makinisti”** - është punëtori i cili drejton mjetin tërheqës.

1.6. **“Konduktor”** - është punëtori, i cili kryen punët e transportit në trenat e udhëtarëve, merr pjesë në nisjen e trenit, por kryen edhe punët e manovruesit përkitazi me manovruesit në tren te treni i vetë, nëse punëtorë të këtillë nuk ka tren përkitazi në stacion.

1.7. **“Frenues-Manovrues”** - personi i cili bën kapjen dhe shkëputjen e lokomotivës para dhe pas formimit të trenit, bën kapjen dhe shkëputjen e vagonëve tek formimi para dhe pas trenit.

1.8. **“Udhëheqës Treni-Ndihmës Makinist”** - Kryen pranimin, kontrollon përgatitjen e trenave, rregullimin e ngarkimit në vagonë, gjendjen e vagonëve dhe bllobave si dhe kontrollon dhe verifikon lokomotivën se a është e furnizuar me naftë, vaj, rërë dhe ujë në sistemin e ftohjes dhe e njofton makinistin.

1.9. **“Kontrollues i Vagonëve”** - është punëtori i cili përveç detyrave të punëtorit kontrollues kryen edhe punët tjera të kontrollimit teknik në mjetet lëvizëse dhe dërgesat të cilat janë parashkruar me rregullore

1.10. **“Personeli i cili merr pjesë drejtpërdrejtë në komunikacionin hekurudhor”** - quhet personeli i cili kryen punët rreth sigurimit të lëvizjes së papenguar dhe të sigurt të trenave dhe mjeteve tjera lëvizëse në komunikacionin hekurudhor.

1.11. **“Personeli i cili interpreton rregulla të komunikacionit”** - quhet personi i cili drejtpërdrejtë punon në interpretimin, përcjelljen, aplikimin dhe kryerjen e punëve sipas rregullave të komunikacionit, në bazë të cilave organizohet teknika e transportit të mallrave dhe udhëtarëve edhe nga të cilat varet rregulli dhe siguria e komunikacionit hekurudhor në të cilin drejtpërdrejtë marrin pjesë punëtorët.

1.12. **“Personeli i cili punon në ngritjen profesionale të punëtorëve të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në komunikacionin hekurudhor”** - janë ata punëtor të cilët punojnë rregulla nga lëmi i shkollimit, trajnimit dhe ngritjes profesionale të punëtorëve të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në komunikacionin hekurudhor.

1.13. **“Personeli i cili punon në organizimin dhe mbikëqyrjen e aplikimit të rregullave në bazë të cilave rregullohet dhe organizohet komunikacioni hekurudhor”** - konsiderohet personi i cili punon në organizimin e punëve të cilat dalin nga rregullat, aplikimi i të cilave ndikon në sigurinë dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor, ushtrimin e mbikëqyrjes në aplikimin e rregullave, personalisht apo përmes organit të veçantë mbikëqyrës.

## **KREU I**

### **PUNËT NË TË CILAT PUNËTORËT MARRIN PJESË DREJTËPËRDREJTË NË KOMUNIKACIONIN HEKURUDHOR**

#### **Neni 4**

1. Profesionet në të cilat punëtorët drejtpërdrejtë marrin pjesë në komunikacionin hekurudhor janë:

**1.1. Në veprimtaritë e komunikacionit:**

- a) Manovruesi-frenuesi.
- b) Depoisti i transportit.
- c) Ndërruesi i binarëve në tërheqjen e trenave.
- d) Konduktori.
- e) Udhëheqësi i trenave.

**1.2. Në veprimtaritë e tërheqjes së trenave:**

- a) Ndhmës makinisti.
- b) Makinisti.
- c) Kontrolluesi i vagonëve.

#### **Neni 5**

1. Përveç profesioneve të cekura më lartë në të cilat punëtorët marrin pjesë drejtpërdrejtë në komunikacionin hekurudhor, kryhen edhe disa detyra të cilat në një shkallë të caktuar kanë ndikim në sigurinë dhe rregullin e komunikacionit hekurudhor.

2. Kualifikimi profesional për këto profesione do të bëhet sipas akteve normative të HK-Trainkos SH. A., të përcaktuara, të cilat edhe do të përcaktojnë se cilat janë këto detyra si dhe cilat do të jenë kushtet unike për përgatitjen profesionale për kryerjen e këtyre punëve.

#### **Neni 6**

1. Punëtorët me kualifikimet e përfshira në nenin 4, mund ti kryejnë punët dhe detyrat e punës sipas kësaj rregullore në mënyrë të pavarur, vetëm nëse e kanë arritur kualifikimin profesional të nevojshëm e të përcaktuar në këtë rregullore.

## Neni 7

### **Kushtet dhe kriteret për arritjen e kualifikimit profesional për punë të pavarur drejtpërdrejtë në komunikacionin hekurudhor**

1. Kushtet dhe kriteret për arritjen e kualifikimit profesional për punë të pavarur drejtpërdrejtë në komunikacionin hekurudhor. Te veprimtaria e komunikacionit hekurudhor punëtorët duhet të kenë këto kualifikime:

**1.1. Frenues-Manovruesi** (për kryerjen e punëve manovruese):

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin frenues-manovrues.
- c) Të ketë punuar së paku një muaj, nën mbikëqyrje në profesionin e manovruesit.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional.

**1.2. Ndërruesi i binarëve-punëtor stacioni** (ndërrues i binarëve në tërheqje):

- a) Të ketë të kryer shkollën mesme të lartë, preferohet drejtimi hekurudhor.
- b) Ka përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin ndërrues i binarëve.
- c) Të ketë punuar së paku dy muaj nën mbikëqyrje në profesionin e ndërruesit të binarëve.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional.

**1.3. Kualifikimin për punëtor ndërrues i binarëve e arrin manovruesi, depoisti i transportit, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin ndërrues i binarëve.
- b) Të ketë punuar së paku dy muaj nën mbikëqyrje në profesionin e ndërruesit të binarëve.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për ndërruesit të binarëve.

**1.4. Konduktor:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin e konduktorit.
- c) Të ketë punuar së paku dy muaj nën mbikëqyrje në profesionin e konduktorit.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional për konduktor.

**1.5. Kualifikimin për konduktor e arrin punëtori-ndërruesi i binarëve, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin konduktor.
- b) Të ketë punuar së paku një muaj nën mbikëqyrje në profesionin e konduktorit.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për konduktor.

**1.6. Kualifikimin për konduktor e arrin frenues-manovruesi, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin konduktor.
- b) Të ketë punuar së paku një muaj nën mbikëqyrje në profesionin konduktor.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për konduktor.

**1.7. Depoisti i transportit, i cili:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë, preferohet Teknik i Transportit Hekurudhor.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin e depoistit transportues hekurudhor.
- c) Të ketë punuar së paku dy muaj nën mbikëqyrje në profesionin e depoistit transportues hekurudhor.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional për depoist transportues hekurudhor.

**1.8. Kualifikimin për depoist transporti e arrin frenues-manovruesi, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin depoist transporti.
- b) Të ketë punuar së paku një muaj nën mbikëqyrje në profesionin e punëtorit të depoist transporti.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për depoist transporti.

**1.9. Kualifikimin për depoist transporti e arrin konduktori, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin depoist transporti.
- b) Të ketë punuar së paku një muaj nën mbikëqyrje në profesionin deposit transporti.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për deposit transporti.

**1.10. Udhëheqës treni-ndihmës makinist, i cili:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë, preferohet Teknik i Transportit dhe Komunikacionit Hekurudhor.

- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin e udhëheqës treni-ndihmës makinisti.
- c) Të ketë punuar së paku katër muaj, nën mbikëqyrje në profesionin e udhëheqës treni,
- d) Të ketë dhënë provimin profesional për udhëheqës treni.

1.10.1. Në përputhje me nenin 7, paragrafi 1.10, pikave a), b), c), d), arritja maksimale në karrierë për udhëheqës i trenit-ndihmës makinist mund të jetë dispeçer i vagonëve.

**1.11. Kualifikimin për udhëheqës treni e arrin konduktori ose ndërruesi i binarëve, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin udhëheqës treni.
- b) Të ketë punuar së paku dy muaj, nën mbikëqyrje në profesionin udhëheqës treni.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për udhëheqës treni.

**2. Veprimtaria e tërheqjes së trenave.**

**2.1. Ndhimës makinist i dizel lokomotivave:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin e ndihmës makinist të dizel lokomotivave.
- c) Të ketë punuar së paku tre muaj, nën mbikëqyrje në profesionin ndihmës makinist të dizel lokomotivave.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional për ndihmës makinist të dizel lokomotivave.

**2.2. Kualifikimin për ndihmës makinist të dizel lokomotivave e arrin ndihmës makinisti i lokomotivës me avull ose ndihmës makinisti i lokomotivës elektrike, i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin ndihmës makinist i dizel lokomotivave.
- b) Të ketë punuar së paku një muaj, nën mbikëqyrje në profesionin ndihmës makinist i dizel lokomotivave.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për ndihmës makinist i dizel lokomotivave.

**2.3. Makinisti i dizel lokomotivave:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë, preferohet drejtimi teknik i makinerisë.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin e makinist.
- c) Të ketë punuar së paku gjashtë muaj nën mbikëqyrje në profesionin makinist dhe gjatë kësaj kohe ka udhëtuar së paku 7000 km në të gjithë llojet e trenave.



d) Të ketë dhënë provimin profesional për makinist të dizel lokomotivave.

2.3.1. Në përputhje me nenin 7, paragrafi 2.3, pikave a), b), c) dhe d) arritja maksimale në karrierë për makinist i dizel lokomotivave, mund të jetë:

- a) Kontrollor i pranim-dorëzimit të lokomotivave,
- b) Mbikëqyrës i lokomotivave,
- c) Dispeçer i vagonëve.

**2.4. Kualifikimin për makinist të dizel lokomotivave e arrin udhëheqësi i trenit-ndihmës makinisti i dizel lokomotivës i cili:**

- a) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin teknik i tërheqjes së trenave-makinist i dizel lokomotivave.
- b) Të ketë punuar së paku tre muaj nën mbikëqyrje në profesionin makinist dhe gjatë kësaj kohe ka udhëtuar së paku 7000 km në të gjithë llojet e trenave.
- c) Të ketë dhënë provimin profesional për makinist të dizel lokomotivave.

**2.5. Kontrolluesi teknik i vagonëve:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë, preferohet drejtimi teknik i kontrollimit të vagonëve apo teknik i makinerisë.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin e kontrollues teknik i vagonëve.
- c) Të ketë punuar së paku gjashtë muaj nën mbikëqyrje në profesionin kontrollues teknik i vagonëve.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional për kontrollues teknik të vagonëve.

**2.6. Kualifikimin për kontrollues teknik të vagonëve e arrin axhustatori dhe mekaniku i mjeteve lëvizëse në hekurudhë, i cili:**

- a) Të ketë të kryer shkollën e mesme të lartë, preferohet drejtimi teknik për kontrollues të vagonëve.
- b) Të ketë përvetësuar programin e aftësimit profesional (trajnimin) për profesionin kontrollues teknik të vagonëve.
- c) Të ketë punuar së paku dy muaj nën mbikëqyrje në profesionin kontrollues teknik të vagonëve.
- d) Të ketë dhënë provimin profesional për kontrollues teknik të vagonëve.

## **KREU II**

### **Neni 8 Praktikantët**

1. Personi i cili në bazë të ligjit të punës pranohet në marrëdhënie pune në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. si praktikant, njëkohësisht konsiderohet edhe si punëtor nën mbikëqyrje i cili gjendet në trajnim profesional në pajtim me këtë Rregullore dhe në këtë pozitë është i obliguar të kalojë aq kohë sa është e paraparë me këtë rregullore.
2. Punë nën mbikëqyrje, është kryerja e punëve dhe detyrave të punës të lidhura me profesionin për të cilin i nënshtrohen provimit profesional dhe janë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga punëtori përgjegjës.
3. Praktikantit gjegjësisht punëtorit nën mbikëqyrje nuk guxon ti lejohet kryerja e punës dhe detyrave të punës në mënyrë të pavarur, nëse ato janë të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e rregullt dhe sigurinë në komunikacionin hekurudhor.
4. Personi përgjegjës është i obliguar të jetë gjithmonë prezent kur kandidati kryen punë ose jep urdhëresa për kryerjen e punëve në komunikacionit hekurudhor.

### **Neni 9**

1. Shtojca 1 e kësaj rregullore përmban planin e trajnimit profesional të praktikantit dhe kohëzgjatjen e punës nën mbikëqyrje.
2. Për praktikantët të cilët kanë kryer shkallën (niveлин) III, IV dhe V sipas (Ligjit nr 04/L-032 për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës) të kualifikimit profesional për profesionet prej 1 deri në 5 të veprimtarive të komunikacionit hekurudhor, puna nën mbikëqyrje organizohet sipas shtojcës 1 të kësaj rregullore.

### **Neni 10 Provimi Profesional**

1. Për kryerjen e punëve gjegjësisht detyrave të punës në të cilat punëtori merr pjesë drejtpërdrejtë në komunikacionin hekurudhor, punëtori në pajtim me këtë Rregullore është i obliguar t'i nënshtrohet provimit profesional.

2. Provimit profesional për secilin profesion hekurudhor, punëtori i nënshtrohet veç e veç sipas kushteve të parapara me këtë rregullore.
3. Provimi profesional mund të kalohet me verifikimin e arritjes së pjekurisë për kryerjen e një profesioni apo për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës të caktuara brenda një profesioni.
4. Te dhënia e provimit profesional për profesione tjera, sipas kësaj rregullore në të njëjtin nivel apo më të lartë të përgatitjes profesionale, pranohen provimet e dhëna me programet e mëparshme profesionale. Në këtë rast punëtori jep vetëm ndryshimin nga programi i mëparshëm i dhënies së provimit profesional për profesionin e mëparshëm në programin për të cilin kërkohet provimi profesional për profesionin e tanishëm.

## **Neni 11**

1. Provimi profesional është i veçantë, përbëhet prej pjesës teorike dhe praktike dhe përmes tij vërtetohet njohuria dhe aftësia e kandidatit për të kryer punë të pavarur në komunikacionin hekurudhor.
2. Në pjesën teorike, kandidati duhet të tregoj njohuri të mjaftueshme teorike për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës për të cilat organizohet provimi, kurse në pjesën praktike ato njohuri duhet ti aplikoj në praktikë me qëllim të pavarësimit në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.

## **Neni 12**

1. Verifikimi i njohurive teorike bëhet përmes testit me shkrim apo përmes pyetjeve të drejtpërdrejta të bëra nga anëtarët e komisionit dhe përgjigjeve të marra nga kandidati. Kurse pjesa praktike verifikohet dhe vlerësohet gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të kandidatit gjatë provimit.
2. Tek dhënia e provimit profesional për profesionin tjetër nga ai që ka, në shkallë të njëjtë apo më të lartë se sa që posedon, kandidati i nënshtrohet provimit vetëm në ndryshimin e lëndëve mes programit me të cilin është dhënë provimi paraprak dhe programit i cili aplikohet për profesionin tjetër.
3. Pjesës teorike të provimit profesional kandidati i nënshtrohet në bazë të programit për dhënien e provimit profesional i cili paraqitet si Shtojcë III e kësaj Rregullore. Pjesës praktike të provimit profesional kandidati i nënshtrohet pas pjesës teorike dhe pas punës nën mbikëqyrje në pajtim me Shtojcën I të kësaj Rregullore.

## **Neni 13**

### **Përbërja e Komisionit**

1. Komisioni përbëhet prej kryetarit të komisionit, së paku dy anëtarëve dhe zyrtarit (zyrtarit të resurseve njerëzore).
2. Punët administrative i udhëheqë zyrtari për kualifikim në kuadër të Sektorit për Trajnime
3. Kryetari i komisionit duhet të ketë kualifikim profesional më të lartë ose të njëjtë me kandidatin i cili i nënshtrohet provimit profesional.
4. Kryetari dhe anëtarët e komisionit, duhet të kenë të dhënë provimin profesional në HK-Trainkos Sh. A. sipas kësaj Rregullore.
5. Së paku një nga anëtarët duhet të ketë të dhënë provimin profesional nga lëmia për të cilën vlerësohet kandidati.
6. Në mesin e anëtarëve të komisionit njëri duhet të jetë nga veprimtaria e komunikacionit hekurudhor.

## **Neni 14**

1. Anëtarët e komisionit i emëron Kryeshefi Ekzekutiv i HK - Trainkos Sh. A., me propozim të Drejtorit të Departamentit të Operimeve.
2. Lista e kandidatëve për anëtarë të komisionit për provim profesional duhet të përmbajë anëtarë të kualifikuar dhe profesional të profesioneve të ndryshme hekurudhore dhe prej këtyre anëtarëve formohet komisioni për secilin rast konkret.
3. Lista mund të plotësohet me vendim të posaçëm ndërsa si tërësi mund të ndryshohet çdo 2 vjet.
4. Anëtarët e komisionit mund të jenë njëkohësisht edhe pyetës.
5. Pjesës teorike dhe praktike të provimit profesional, kandidati i nënshtrohet para komisionit të njëjtë pyetës.

## Neni 15

1. Kandidati është i obliguar që së paku 15 ditë para përfundimit të afatit të punës nën mbikëqyrje, të bëjë kërkesë për dhënien e provimit profesional.
2. Kërkesën për lejimin e dhënies së provimit profesional kandidati e ushtron përmes mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.
3. Kërkesës për dhënien e provimit profesional i bashkëngjiten të dhëna të nevojshme lidhur me plotësimin e kushteve për dhënien e provimit.
4. Në bazë të dhënave mbi plotësimin e kushteve, HK-Trainkos Sh. A. lejon mbajtjen e provimit profesional dhe njëherazi formon komisionin pyetës.
5. Kandidati i cili ka bërë kërkesë dhe i ka plotësuar kushtet ligjore për dhënien e provimit profesional, duhet të thirret më së largu 30 ditë pas ushtrimit të kërkesës.
6. Për datën e mbajtjes së provimit kandidati njoftohet me shkrim 8 ditë para datës së mbajtjes së provimit.

## Neni 16

1. Provimet profesionale janë publike.
2. Komisioni vlerëson njohurinë e tërësishme të kandidatit. Komisioni vendimin e merr me shumicë votash. Suksesi i kandidatit vlerësohet me **“Kalon”** ose **“Nuk Kalon”**.

## Neni 17

1. Kandidati i cili nuk tregon rezultat në provim, ka të drejtë që të hyj në riprovim, së paku një muaj, ose më së largu dy muaj nga dita e mbajtjes së provimit paraprak.
2. Provimi profesional mund të përsëritet jo më shumë se dy herë.
3. Në qoftë se kandidati nuk lajmërohet për riprovim në afatin e paraparë me këtë Rregullore, udhëheqësi drejtpërdrejtë me vet iniciativë, mund ta detyrojë kandidatin që ti nënshtrohet provimit profesional.
4. Në qoftë se kandidati refuzon ti nënshtrohet provimit profesional, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin profesional.

5. Kandidati konsiderohet se e ka dhënë provimin profesional në pjesën teorike, në qoftë se ka treguar rezultat në të gjitha lëndët e parapara me këtë Rregullore.
6. Me rastin e riprovimit, kandidatit i pranohen të gjitha lëndët e dhëna nga provimi paraprak.
7. Sipas suksesit të treguar në pjesën teorike të provimit dhe punës nën mbikëqyrje kandidati është i gatshëm që ti nënshtrohet pjesës praktike të provimit profesional.
8. Në qoftë se kandidati nuk e kalon provimin profesional në pjesën praktike brenda afatit prej gjashtë muajsh, është i obliguar që të hyj në riprovim edhe në pjesën teorike.
9. Kandidati i cili për të tretën herë i nënshtrohet provimit profesional dhe nuk e kalon pjesën praktike, për këtë pjesë mund t'i nënshtrohet provimit edhe dy herë tjera brenda afatit prej gjashtë muajsh.
10. Për çdo riprovim (pjesa teorike dhe praktike) kandidati duhet të paraqesë kërkesë të re, të cilës ia bashkangjet raportin mbi mbajtjen e provimit paraprak. Kandidati i cili as për të tretën herë nuk e kalon provimin profesional si tërësi, e humb të drejtën për dhënien e provimit për atë profesion.
11. Kandidati i cili e ka humbur të drejtën për dhënien e provimit profesional ka të drejtë ankese pranë Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, tek organi për licencim dhe certifikim në afat prej 15 ditëve,
12. Me rastin e humbjes së të drejtës për dhënien e provimit profesional kandidati njoftohet me shkrim.
15. Në qoftë se kandidati në afat prej gjashtë muajve prej kur e ka dhënë pjesën teorike të provimit, nuk e jep edhe pjesën praktike, është i obliguar që në afatin vijues t'i nënshtrohet provimit në tërësi (pjesa teorike dhe praktike).
16. Për çdo riprovim kandidati është i obliguar të paraqesë kërkesë me shkrim, në të cilën i evidenton edhe rezultatet nga afati paraprak i nënshtimit të provimit.

## **Neni 18**

1. Testimi e kandidatit bëhet sipas programit për dhënien e provimit profesional për secilin profesion veç e veç. Tek dhënia e provimit profesional pjesa praktike, duhet të merren parasysh kushtet dhe rrethanat nën të cilat punëtori i kryen punët dhe detyrat e punës të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në kryerjen e këtyre detyrave.

## **Neni 19**

1. Komisioni duhet ta testojë kandidatin me shkrim dhe me goje në mënyrë që të bëjë verifikimin e njohurive të kandidatit nga lëmi i njohjes së dispozitave të cilat kandidati nuk i ka aplikuar ose i ka aplikuar gabimisht gjatë kryerjes së detyrave të punës.

## **Neni 20**

1. Kandidati i cili e kalon provimin profesional, i lëshohet certifikata.
2. Certifikatën e lëshon Kompania, ndërsa e nënshkruan Kryeshefi Ekzekutiv. Certifikata mbi dhënien e provimit profesional i jep kandidatit mundësi që në mënyrë të pavarur të kryej punët dhe detyrat e punës nga profesioni i caktuar. Ndërsa pas certifikimit kandidati ka të drejt ti nënshtrohet licencimit, proces ky të cilin e kryen ARH-ja.
3. Për rezultatin e provimit njoftohet Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore.
4. Në qoftë se pas dhënies së provimit profesional vërtetohet se ka pasur shkelje të procedurave ligjore nga ana e komisionit dhe kandidati nuk i ka plotësuar kushtet për dhënien e provimit, Kryeshefit Ekzekutiv ka të drejtë ta anulojë provimin dhe ta revokojë certifikatën.

## **Neni 21**

1. Për mbarëvajtjen e provimit, mbahet procesverbal. Procesverbali përmban të dhëna mbi llojin e provimit profesional, datën e mbajtjes së provimit, komisionin verifikues, të dhëna për kandidatin dhe shënime tjera të nevojshme.
2. Procesverbalin e provimit profesional e nënshkruan kryetari i komisionit, anëtarët dhe procesmbajtësi.
3. Kryetari i komisionit është i obliguar që më së largu 15 ditë nga dita e mbajtjes së provimit të dërgoj procesverbalin në sektorin për çështje ligjore dhe resurse njerëzore.
4. Procesverbali mbi mbajtjen e provimit profesional ruhet në vazhdimësi në dosjen e kandidatit. Formulari i procesverbalit të komisionit për provime është pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.

## **Neni 22**

Punët administrative rreth provimit personal (sjelljen e vendimeve, vërtetimin, ruajtjen e procesverbalit, evidencat, statistikat etj.) i udhëheq Departamenti i Administratës.

## **Neni 23**

1. Në pajtim me këtë Rregullore organizohet provimi profesional edhe për profesionet nga kategoria e III dhe IV e kualifikimit shkollor si:

**1.1. Në veprimtaritë e komunikacionit hekurudhor për profesionet:**

- a) Bachelor Inxhinier i Komunikacionit Hekurudhor.
- b) Master Inxhinier i Komunikacionit Hekurudhor.

**1.2. Në veprimtaritë e tërheqjes së trenave dhe mjeteve tërheqëse:**

- a) Bachelor dhe Master Inxhinier i Makinerisë - Drejtimi Hekurudhor.
- b) Bachelor dhe Master Inxhinier i Elektroteknikës - Drejtimi Hekurudhor.

1.3. Punëtorët e këtyre profesioneve i nënshtrohen provimit profesional sipas kësaj Rregullore, shtojca III, e cila detyrimisht përmban edhe programin për profesionet:

- a) Në veprimtaritë e transportit për teknikun e komunikacionit hekurudhor,
- b) Në veprimtaritë e tërheqjes së trenave për makinistin dhe kontrolluesin e vagonëve.



### **KREU III**

## **SHKOLLIMI I RREGULLTË DHE VERIFIKIMI I NJOHURIVE**

### **Neni 24**

#### **Shkollimi i rregullt**

1. Punëtorët e Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh. A., të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me sigurinë në komunikacionin hekurudhor, janë të obliguar që në mënyrë permanente të përvetësojnë, përsërisin dhe plotësojnë njohuritë e tyre profesionale. Përveç vetë iniciativës së punëtorit, ekzistojnë edhe mënyrat institucionale të organizimit të mësimit të rregullt.
2. Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A., mund të organizojnë mësim të rregullt edhe për profesionet tjera, nëse kjo paraqitet si domosdoshmëri.

### **Neni 25**

1. Qëllimi i vetë aftësimit dhe mësimit të rregullt është që punëtorët të aftësohen në mënyrë të pavarur, të drejtë dhe në afat të caktuar të vendosin, për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.
2. Përveç me përsëritje të njohurive punëtorët me forma dhe metoda të ndryshme të organizimit të shkollimit, njoftohen edhe me ndryshimet, plotësimet e dispozitave të rregulloreve dhe udhëzimeve të Hekurudhës, të arriturat tekniko teknologjike të punës, dhe me shumë risi dhe specifika tjera.
3. Gjithashtu në shembujt konkret, analizohen parregullsitë dhe rastet e jashtëzakonshme për secilin rast, bëhen analizat e rasteve dhe kërkohen zgjidhje për zvogëlimin ose mënjanimin e tyre.
4. Me shkollim të rregullt i jepet rëndësi kryesore sigurisë në komunikacionin hekurudhor dhe sigurisë personale të udhëtarëve.

### **Neni 26**

1. Organizimin dhe përcjelljen e mësimit të rregullt për punëtorët e Trainkos Sh. A., të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në Transportin Hekurudhor e bën Sektori për Trajnim dhe Kualifikim.

## **Neni 27**

1. Mësimi organizohet në sallat dhe vendet e dedikuara për mësim të cilat do të jenë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimi.
2. Në orët e mësimi të rregullt nuk prezantojnë punëtorët të cilët dalin nga ndërimi i natës.

## **Neni 28**

1. Mësimin në shkollimet e rregullta e mbajnë ekspertët e lëmive përkatëse. Nëse nuk ka ekspert të lëmive përkatëse, këto trajnime i kryejnë personat e autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i HK Trainkos Sh. A.
2. Trajnerët e lëmive përkatëse duhet të kenë kualifikim shkollor, Bachelor ose Master.
3. Në qoftë se shkollimi i rregullt mbahet nëpër qendra shkollore, mësimin e mbajnë arsimtarët.
4. Në disa raste specifike thirren edhe ekspert nga drejtimet relevante.

## **Neni 29**

1. Shkollimi i rregullt organizohet në bazë të planeve dhe programeve të hartuara nga Departamentet dhe Sektorët. Këtu përfshihen grupet e profesioneve, koha e mbajtjes së provimeve, fondi i orëve për realizimin e planit etj.
2. Trajneri gjegjësisht personi i autorizuar për mbajtjen e trajnimeve e harton planin konkret për organizimin e mësimi, sipas shtojcës II

## **Neni 30**

1. Rreth parregullsive, rasteve të jashtëzakonshme dhe të njëjta, mbajtësit e mësimi njoftohen nga zyra e kontrollit e cila edhe konstaton parregullsitë dhe jep udhëzime për mënjanimin e tyre.
2. Për të gjitha parregullsitë dhe gabimet e konstatuara nga zyra e kontrollit njoftohen shefat e njësive dhe Menaxherët e Sektorëve, të cilët obligohen për ndërmarrjen e masave adekuate me qëllim të eliminimit të lëshimeve të konstatuara.

### **Neni 31**

1. Në rast të arriturave dhe ndryshimeve të mëdha tekniko-teknologjike dhe sjelljes së udhëzimeve të reja lidhur me profesionet e punës mund të organizohen seminare pune të veçanta për punëtorët.
2. Pas mbajtjes së seminarit është e obliguar që të verifikohen njohuritë e arritura nga seminari.
3. Rezultati shënohet në formularët për mbajtjen e provimeve periodike.
4. Në qoftë se punëtori nuk tregon sukses në përvetësimin e njohurive nga seminari i parë, mund të dërgohet në mësim plotësues. Derisa punëtori nuk tregon sukses të kënaqshëm në përvetësimin e njohurive, nuk mund të caktohet në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës të cilat janë të lidhura me punët ku punëtori nuk ka treguar njohuri të mjaftueshme.
5. Verifikimi i njohurive pas mbajtjes së shkollimit të rregullt mund të bëhet më së shumti dy herë.
6. Nëse punëtori nuk tregohet i suksesshëm, nuk mund të sistemohet në punët dhe detyrat e punës të lidhura drejtpërdrejtë me sigurinë në komunikacionin hekurudhor.

### **Neni 32**

1. Për të treguar shkollim sa më kualitativ, punëtorët e autorizuar mund të përdorin të gjitha mjetet më moderne për mësim siç janë: kompjuterët, materialin fotografik, video incizimet. Sipas marrëveshjes mund të përdoren edhe kabinetet e shkollave apo institucioneve profesionale për lëmi të caktuara.

### **Neni 33**

1. Punëtorët janë të obliguar që të ndjekin mësimet në shkollimin e rregullt sipas plan programit.
2. Për pjesëmarrje në mësim mbahet evidence në librin e mësimimit.
3. Çdo mungesë e pa arsyeshme në orët e shkollimit llogaritet si mungesë nga puna.
4. Në librin e shkollimit të rregullt regjistrohen edhe të dhënat mbi përmbajtjen dhe temat e mbajtjes së mësimimit.

## **Neni 34**

### **Verifikimi i rregullt periodik i njohurive**

1. Aftësia profesionale e punëtorëve të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në sigurinë e komunikacionit hekurudhor, verifikimi i njohurive lidhur me profesionin që ushtrojnë bëhet çdo 3 vite, kurse në mënyrë të jashtëzakonshme mund të verifikohen edhe më shpesh.
2. Provimit periodik në mënyrë të detyruar i nënshtrohen të gjithë punëtorët profesionet e të cilëve janë të lidhura drejtpërdrejtë me sigurinë në komunikacionin hekurudhor.
3. Koha e mbajtjes së provimeve periodike organizohet nga Departamenti i Administratës -Sektori për çështje ligjore dhe resurse njerëzore.
4. Me mbajtjen e provimeve të rregullta periodike verifikohen njohuritë teorike të punëtorëve lidhur me risitë normative me të cilat rregullohet zhvillimi i sigurt i komunikacionit hekurudhor.
5. Provimi periodik kalohet para komisionit të emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv.
6. Në provimin periodik verifikohet njohuria, gjegjësisht aftësia profesionale sipas programit për dhënien e provimit profesional lidhur me profesionin e caktuar me qëllim që të njoftohet me risitë në lëmin e rregullimit të komunikacionit hekurudhor dhe teknologjisë së re.
7. Verifikimi i aftësisë profesionale ka të bëjë me aftësimin e duhur për vendin e punës në të cilin punëtori punon.
8. Njohuria profesionale mund të verifikohet me gojë, me testim me shkrim ose në mënyrë të kombinuar. Testet i verifikon komisioni i formuar enkas për provime periodike.

## **Neni 35**

### **Verifikimi i jashtëzakonshëm periodik i njohurive**

1. Provimi i jashtëzakonshëm periodik mbahet në këto raste:
  - a) Me urdhëresë të posaçme;
  - b) Me rastin e nxjerrjes së rregullave të reja të komunikacionit, sjelljes së mjeteve të reja për punë, dhe rrethanave tjera tekniko - teknologjike të cilat punëtori në bazë të vendit të punës që ka, është i obliguar ti njohë;
  - c) Kur punëtori në mënyrë të ashpër shkel mbi rregullativen ose dukshëm nuk i njeh ato;
  - d) Lidhur me obligimin e mbajtjes së këtyre provimeve vendos Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të kërkesës së kontrollës ose drejtorit të departamentit përkatës;

- e) Brenda e provimit të jashtëzakonshëm rregullohet me vendimin mbi mbajtjen e këtyre provimeve, pa urdhërese të posaçme.
2. Para se të filloj kryerjen e punëve të cilat janë drejtpërdrejtë të lidhura me sigurinë në komunikacionin hekurudhor, punëtori i nënshtrohet provimit periodik edhe pa urdhëresë të posaçme, për punët dhe detyrat e punës të cilat pa marrë parasysh shkakun, nuk i ka ushtruar më shumë se gjashtë muaj.
3. Procedura e mbajtjes së provimit periodik të jashtëzakonshëm, është e njëjtë me atë të provimit periodik të rregullt, përveç në rastin kur provimi organizohet me rastin e nxjerrjes së rregullave të reja të komunikacionit, sjelljes së mjeteve të reja për punë, dhe rrethanave tjera tekniko – teknologjike, të cilat punëtori në bazë të vendit të punës që ka, është i obliguar ti njohë.
4. Për kryerësit e punës, udhëheqës treni-ndihmës makinist dhe makinist organizohet provimi i jashtëzakonshëm periodik: Në qoftë se nga dhënia e provimit profesional deri te aftësimi për kryerjen e pavarur të punëve dhe detyrat e punës në komunikacionin hekurudhor kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj.

### **Neni 36**

#### **Udhëheqësi i trenave-ndihmës makinisti**

1. Para se të kaloj në kryerjen e detyrave të punëve në mënyrë të pavarur duhet që makinisti:
- 1.1. Nga dhënia e provimit profesional deri te aftësimi për kryerjen e pavarur të punëve dhe detyrave të punës në komunikacionin hekurudhor kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj.
- 1.2. Nëse punëtori nga cilado arsye nuk ka mundur të ushtrorë punët dhe detyrat e punës së makinistit më shumë se gjashtë muaj, duhet t'i nënshtrohet provimit të jashtëzakonshëm.
2. Në qoftë se punëtori krahas provimit periodik të jashtëzakonshëm i nënshtrohet edhe pjesës praktike të provimit dhe këtë pjesë të provimit nuk e jep rekomandohet që edhe më tutje të vazhdojë punën nën mbikëqyrje, deri në afatin e paraparë për përsëritjen, dhënies së provimit.

### **Neni 37**

#### **Puna e jashtëzakonshme praktike nën mbikëqyrje**

1. Në punë praktike të jashtëzakonshme nën mbikëqyrje do të caktohet punëtori i cili do të kryej punët dhe detyrat e punës udhëheqësi i trenit-ndihmës makinist, konduktori, frenues-manovrues:

- 1.1. Kur më pare nuk ka kryer kurrfarë detyre të personelit të trenit në hekurudhë (vijë) të panjohur.
  - 1.2. Kur në vijë hekurudhore nuk ka kryer detyra të personelit të trenit më gjatë se një vit, në qoftë se nga dhënia e provimit profesional deri te ushtrimi i detyrës në mënyrë të pavarur, kanë kaluar më tepër se gjashtë muaj, në qoftë se për çfarëdo arsye nuk e ka ushtruar më shumë se gjashtë muaj detyrën e makinistit.
  - 1.3. Në qoftë se më parë nuk ka kryer kurrfarë pune të personelit të lokomotivës më gjatë se gjashtë muaj.
  - 1.4. Kur më pare nuk ka ushtruar detyra të personelit të lokomotivës në vijë të panjohur hekurudhore.
2. Punëtori i komunikacionit transportues (ndërruesi i binarëve):
    - 2.1. Kur duhet të punohet në vendet e punës me SS stabilimente, të cilat para dhënies së provimit profesional nuk i ka përdorur ose kur numri stabilimenteve që do të përdoren është me numër të madh të elementeve të cilat duhet të përdoren.
    - 2.2. Nëse kalohet për punë në stacione me ndërlikueshmëri më të madhe të mënyrave të kryerjes së shërbimeve të komunikacionit
3. Kohëzgjatjen punës së jashtëzakonshme nën mbikëqyrje e cakton shefi i shërbimit ose udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punëtorit
  4. Puna e praktike e jashtëzakonshme dhe nën mbikëqyrje nuk mund të jetë më e shkurtër se dy ndërrime të ditës dhe dy ndërrime të natës për drejtuesin e trenave, dhe punëtorin e stacionit.
  5. Kurse udhëheqësi i trenit-ndihmës makinisti konduktori, frenuesi, makinisti janë të obliguar që më së paku të bëjnë një vozitje ditën, e një vozitje natën në të dy drejtimet hekurudhore
  7. Punëtori mund të filloj punën e pavarur vetëm pasi të ketë deklaruar me shkrim se është njoftuar me risitë tekniko-teknologjike dhe normativën e re hekurudhore dhe i ka përvetësuar ato.
  8. Vendimin për këtë e merr shefi i shërbimit në bashkëpunim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë të punëtorit i cili ishte nën mbikëqyrje.

## Neni 38

### Vlerësimi i provimeve periodike

1. Suksesi i provimit periodik vlerësohet me **“Kaloi”**, **“Nuk kaloi”**.
2. Punëtorit i cili në provim periodik nuk është treguar i suksesshëm, i ndalohet çdo ushtrim i detyrave të punës, i lidhur drejtpërdrejtë me sigurinë në komunikacionin hekurudhor, derisa për herë të dytë ti nënshtrohet provimit dhe të tregojë aftësi të mjaftueshme.
  - 2.1. Punëtori mundet dy herë të përsërisë provimin periodik. Afati për riprovim nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj nga provimi i mëparshëm.
  - 2.2. Datën e provimit e cakton komisioni.
  - 2.3. Punëtori i cili as për të tretën herë nuk e kalon me sukses provimin, këtë mund ta bëjë vetëm në periudhën tjetër të provimeve të rregullta periodike.
3. Resurset njerëzore mbajnë evidencë vjetore të provimeve periodike për secilin punëtor.
  - 3.1. Me rastin e mbajtjes së provimeve periodike profesionale përpilohet raport me shkrim.
  - 3.2. Për secilin punëtor i cili i nënshtrohet provimit profesional mbahen shënime në librin e shënimeve (noter).
  - 3.3. Libri i shënimeve nënshkruhet nga kryetari i komisionit.
4. Përveç përgjegjësisë që mban punëtori për zhvillimin dhe mbajtjen e rregullt të provimeve periodike për verifikimin e aftësive profesionale, përgjegjësi të posaçme mbajnë edhe:
5. Shefi i shërbimit për përcjelljen e pjesëmarrjes së rregullt të punëtorëve në shkollim të rregullt, për vërtetimin e rezultateve nga shkollimi, për dhënien e propozimeve lidhur me shkollimin etj.
6. Punëtori i autorizuar për shkollimin (trajneri) bënë përgatitjen e plan programit për shkollim, shqyrton të gjitha vërejtjet dhe propozimet lidhur me mbajtjen e mësimit, kujdeset për kualitetin e mësimit etj.
7. Organi i kontrolles së brendshme e përcjellë mënyrën se si njohuritë e fituara aplikohen në punë, jep vërejtje në gabime dhe parregullsi dhe jep propozime për mënjanimin e tyre.

**Neni 39**  
**Dispozitat Kalimtare**

Kjo rregullore nuk i zëvendëson të gjitha dispozitat e rregullores 646 të ish – RSFJ dhe vlen vetëm për punët e brendshme të HK - Trainkos Sh. A.

**Neni 40**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të HK – Trainkos Sh. A.



**Heset Cakolli**

**Kryesues i Bordit të HK Trainkos Sh.A.**